



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 21

Prishtinë, më 16.09.2015 ora: 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

i mbledhjes së komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaçu, Alma Lama Shqipe Pantina, Pal Lekaj, Zafir Berisha dhe Jelena Bontic.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e: KDI dhe OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Diskutim i Komisionit rreth realizimit të planit të punës;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Diskutim i Komisionit rreth realizimit të planit të punës;

Zenun Pajaziti – ai tha, kemi mbetur prapa me shqyrtimin e çështjeve që sipas planit të punës së komisionit i kemi tejkaluar procedurat e rregullta, propozoi që në mbledhjen e radhës të fillohet me shqyrtimin e P/ligjit për procedurën e përgjithshme administrative dhe të fillohet me plotësim ndryshimin e Ligjit për RTK-në, siç e dimë çështja e financimit të RTK-së është çështje me delikate dhe mbi bazë të iniciativës që kemi marrë duhet të përballemi me këtë dhe pasi që kjo

është një çështje e ndjeshme, ai kërkoi nga anëtarët e komisionit që të marrin qëndrimet partiake dhe me qëndrimet e tyre të fillojmë punën në komision, sipas rregullave të Kuvendit për procedim d.m.th pastaj i dërgohet Qeverisë për mendim.

Xhevahire Izmaku- propozoi të mbahet punëtori për shqyrtimin e P/ligjit për procedurën e përgjithshme administrative dhe Ligjit për RTK-në.

Shqipe Pantina -tha se, në fakt janë tri P/ligje në procedurë, ashtu siç është dakorduar komisioni, duke përfshirë edhe plotësim ndryshimin e Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe një çështje, jashtë rendit të ditës, çështja e asociacionit të komunave serbe bie në fushëveprimtarinë e komisionit, ne duhet të diskutojmë përfshirë edhe marrëveshjen për asociacionin si të tillë ose ti japim qëndrimet tona, ajo propozoi që të ftohet Ministri i pushtetit lokal në interpelancë në komision.

Alma Lama – lidhur me plotësim ndryshimin e Ligjit për RTK-në, ajo propozoi që grupi punues të udhëhiqet nga vet ajo.

Xhevahire Izmaku - propozoi që në grupin punues për plotësim ndryshimin e Ligjit për RTK-në të jetë komisioni në përbërje të plotë dhe të kryesohet nga kryetari i komisionit.

Zenun Pajaziti – u pajtua me propozimin e znj. Xhevahire Izmaku.

Pal Lekaj - tha se vizitat për monitorimin e ligjeve që komisioni ka në procedurë kanë ngec për arsye të ndryshme, disa institucione kanë injoruar kërkesën e komisionit. Sa i përket çështjes së asociacionit të komunave, ai u pajtua me diskutimin e znj.Shqipe Pantina që të diskutohet për marrëveshjen e asociacionit në mënyrë që komisioni të nxjerrë përfundimet se a është në fakt asociacioni OJQ, apo ka diçka më tepër që asociacioni e atakon kushtetutshmërinë e Kosovës.

Zafir Berisha – propozoi që për muajin dhjetor komisioni të planifikojë raportimin e ministrave të atyre ministrive që bien në fushëveprimtarinë e komisionit.

Sadri Ferati - tha se, me kryetarin e komisionit jemi dakorduar që në këtë mbledhje të planifikohet si të punohet në muajt e ardhshëm, meqë komisioni është i ndarë në disa grupe punuese, sa i përket ndryshimit të Ligjit për RTK-në, tha se aty është një moment politik pasi që vet mënyra e financimit të RTK-së është politike dhe nëse nuk gjendet mënyrë tjetër e financimit, atëherë RTK-ja si medium publik duhet të shndërrohet në medium shtetëror, andaj fillimisht duhet të zgjidhen këto dy momente politike dhe nëse mendohet se janë plotësuar kushtet mund të fillohet me ndryshim të ligjit, nëse jo duhet ti sqarojmë këto dy çështje , d.m.th çështjen se a është medim publik apo shtetëror dhe a ka pajtueshmëri për mënyrën e financimit.

Sa i përket P/ligjit për procedure e përgjithshme administrative, propozoi të mbahet një punëtori dy ditore, sa i përket asociacionit të komunave, meqë nesër në Kuvend është si pikë e rendit të ditës kjo çështje, aty do të kemi mundësinë të diskutojmë dhe nëse pas asaj vendoset që të

kërkohet mendim nga komisionet, ne do të shfrytëzojmë mundësinë tonë për shqyrtim në komision.

Konstatim- komisioni vendosi që nga java e ardhshme të fillohet me aktivitetet e grupeve punuese dhe amendamentimin e P/ligjeve në procedure, ndërsa sa i përket çështjes së asociacionit të komunave serbe, ai u pajtua që të diskutohet edhe në komision por u deklarua që të gjitha debatet për çështjen në fjalë do të shterren në seancën e radhës të Kuvendit.

3. Të ndryshme

Xhevahire Izmaku - duke shpreh shqetësim për etikën e mediave, tha se nuk di sa është duke e përcjellë KPM-ja, etikën e mediave dhe lidhur me këtë ajo propozoi që të organizohet një debat i gjerë, ku do të ftoheshin të gjitha televizionet duke përfshirë edhe transmetuesin publik.

Shqipe Pantina - propozoi që të ftohet KPM-ja për raportim apo njoftim, lidhur me digjitalizimin, si dhe të ftohet Bordi i RTK-së, pasi që bordi ka obligim ligjor të raportojë çdo tre muaj para komisionit.

Zenun Pajaziti -u pajtua me propozimet e sipërsënuara dhe kërkoi nga propozueset që të dakordohen për caktimin e datave.

Mbledhja përfundoi në ora: 12:15.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit
Zenun Pajaziti**
